REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.44, datë 20/07/2005

"PËR NJË SHTESË FONDI INVESTIMESH NË BUXHETIN E NJËSISË BASHKIAKE NR.5 PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË 10% NË PROJEKTIN "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS LIDHJA E PRIZRENIT" DHE "NDËRTIMI I KUZ NË RRUGËN HAMDI PEPA" ME FSHZH"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32/dh, ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", neni 6, pika 2 e 4, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal" neni 18, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.8, dt.27/01/2005 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2005", pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë një shtesë fondi për investime në buxhetin e Njësisë Bashkiakë Nr.5 në shumën 1.475.565 lekë, me destinacion kontributin e 10% të komunitetit në realizimin e projektit "Për rikonstruksionin e Rrugës "Lidhja e Prizrenit" dhe "Ndërtimin e KUZ në Rrugën "Hamdi Pepa", financuar nga FSHZH.

2. Efektet financiare të mbulohen nga fondi rezervë i Bashkisë së Tiranës në buxhetin e vitit 2005.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Njësia Bashkiake Nr.5.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI